



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1322/5 Prot.

Durrës më, 06/10 /2021

V E N D I M

Nr. 62 Datë 06/10 2021

"Për shpalljen e aplikimeve për plotësimin e vendit vakant anëtar student të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës "

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, të Rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, të vendimit të Senatit Akademik nr.57, datë 26.05.2020, shkresës së FSHPJ nr.1197/3, datë 28.09.2021 "Informacion mbi statusin e studentëve", Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Shpalljen e aplikimeve për plotësimin e vendit vakant anëtar (përfaqësues student) të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Kandidatët studentë për anëtar të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standarteve të Cilësisë vetëkandidohen.
3. Kandidatët do të dorëzojnë pranë Sekretarisë së Senatit Akademik dokumentacionin si mëposhtë:
 - a) Kërkesën për kandidim;
 - b) Vërtetim studentit;
 - c) Kopje të dokumentit të identifikimit.
4. Afati për dorëzimin e dokumentacionit nga data 6.10.2021 deri në datën 13.10.2021.
5. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar Sekretaria e Senatit Akademik, do të përcjellë listën e kandidaturave të regjistruara për shqyrtim në Senatën Akademik.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Dekanët e Fakulteteve
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Ksënela SOTIROFSKI